



**Raporti Vjetor i Aktiviteteve të  
“Komunitetit Shqiptar të Gjenevës”  
Shtator 2024 – Gusht 2025**



31 Gusht 2025

## 1. 50 vjetori i lagjes " LES AVANCHETS", 13 - 15 shtator 2024

Nga 13 deri më 15 shtator 2024 lagja "Les Avanchets" festoi 50 vjetorin e saj ku atmosfera u mbush me aktivitete të ndryshme argëtuese, ushqime shumëngjyrëshe dhe performanca nga artistë e grupe të ndryshme. Më 14 shtator, Grupi Hareja defiloj me krenari dhe u prezantua para publikut me disa këngë të zgjedhura tradicionale – një moment i veçantë që u duartrokoi me entuziazëm.

Shoqata "Komuniteti Shqiptar" solli një aromë atdheu përmes një standi me ëmbëlsira tradicionale shqiptare. Kontributet e mbledhura do të ndihmojnë në organizimin e pjesëmarrjes së Grupit "Hareja" në Festivalin në Kalabri, që do të mbahet në gusht 2025.



## 2. Kermesse de Meyrin – Grupi "Hareja", 9 nëntor 2024

Të ftuar nga Komuna e Meyrin më 9 nëntor 2024, Grupi "Hareja" u prezantua me disa pika muzikore në festën e kësaj komune, për të mbështetur "Kermesse de Meyrin". Fondet e mbledhura nga ky aktivitet do të shërbejnë gjithashtu për të ndihmuar pjesëmarrjen e Grupit "Hareja" në Festivalin në Kalabri, në gusht 2025.

## 3. FESTA E FLAMURIT SHQIPTAR, Gjenevë me 30 nëntor 2024

Më 30 nëntor 2024, në një atmosferë të veçantë festive, Këshilli Organizativ i Shoqatave Shqiptare në Gjenevë – i përbërë nga KShGj, LAPSH-i, Rinia Contact, Ansambli "Gëzuar", Shoqata e Studentëve Shqiptarë të Gjenevës, FC Kosova dhe Shoqata Zhegra – organizoi me sukses Festën e Flamurit Kombëtar. Në sallën e stërbushur në Onex, përveç kremtimit të 112-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, u nderuan edhe dy data të rëndësishme për historinë tonë të re: Ditëlindja e Komandantit dhe Heroit Kombëtar Adem Jashari, si dhe Dita e daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Programi i pasur kulturor nën drejtimin artistik të znj. Afërdita Krasniqi, u përcoll me emocion nga publiku, duke reflektuar krenarinë dhe lidhjen e fortë me rrënjët tona kombëtare. As këtë vit në skenë nuk munguan edhe studentët e sapodiplomuar të cilëve në emër të shoqatës së KSHGJ-së z. Ali Mehmeti u ndau nga një mirënjohje.



Të pranishëm në këtë ngjarje ishin edhe përfaqësues të institucioneve komunale dhe kantonale, si dhe përfaqësues të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, duke i dhënë ngjarjes edhe më shumë rëndësi dhe vlerësim zyrtar.



#### 4. Promovimi i veprave të Emin Azemit, 31 janar 2025

Më 31 janar 2025, në sallën e Komunitetit Shqiptar të Gjenevës, në Quartier de l'Étang, u zhvillua një mbrëmje kulturore e veçantë, ku u promovuan tri vepra të autorit të njohur Emin Azemi: "Helena e epikes sonë tragjikomike", "Në mes të kauzes dhe mbijetesës" dhe "A kurohet mëndësia".

Përballë një salle të mbushur me bashkatdhetarë, u zhvillua një bashkëbisedim i frytshëm me vetë autorin dhe dy panelistët e ftuar, z. Gani Bytyqi dhe z. Ali Mehmeti. Gjatë diskutimit u shpalesën temat, mesazhet dhe sfidat që përcjellin këto vepra, duke nxitur



reflektim dhe debat mes të pranishmëve. Ky aktivitet u përcoll edhe me dy pika muzikore nga grupi muzikor « Hareja ».



## 5. Promovimi i librit “Shekulli i parë” nga Sejmen Gjokoli, “Mjeshtër i Madh” – mbajtur në Gjenevë, më 4 prill 2025

Më 4 prill 2025, në ambientet e UniMail-it në Gjenevë, u organizua promovimi i librit “Shekulli i parë” nga autori Sejmen Gjokoli, “Mjeshtër i madh”. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim mes Shoqatës së Studentëve Shqiptarë në Gjenevë dhe Komunitetit Shqiptar, duke sjellë një mbrëmje kulturore me shumë vlera historike dhe artistike. Gjatë promovimit u nderua me shumë respekt kujtimi i profesor Astrit Lekës, një personalitet i çmuar dhe burim frymëzimi për komunitetin tonë.

Gjatë mbrëmjes u prezantua edhe një film dokumentar kushtuar 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, i cili ofroi një pasqyrë të thellë dhe emocionuese mbi momentet kyçe që shënuan historinë e shtetit tonë Shqiptar.



Të pranishëm ishin edhe perfaqesues zyrtarë nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë, nga Konsullata e Republikës së Kosovës këtu në Gjenevë, nga Lidhja e Shkrimtarëve të diasporës, përfaqësues nga Hora Arbëreshe dhe media të shkruara. Aktiviteti u shoqërua me pika të zgjedhura muzikore të interpretuar nga grupi muzikor « Hareja », « Art Bend » artistit i mirënjohur Ilir Bytyqi dhe nga dueti i të rinjve Elion Krasniqi dhe Ejona Bytyqi.

## 6. Stand up Comedy, 9 prill 2025

Më 9 prill 2025, në École du Bosson u zhvillua një mbrëmje Stand-up Comedy me Valina Muçolli dhe Esat Shabani nga Prishtina. Gjatë mbremjes ata argëtuan të pranishmit me tregimet e tyre humoristike dhe atmosferë plot gaz.



## 7. EPER – Sigurimet shoqërore në Zvicër, AVS-i, 11 prill 2025

Në bashkëpunim me Shoqatën EPER, më 11 prill 2025 në sallën e Quartier de l'Étang, u organizua një seancë informative mbi sigurimet shoqërore, me ekspertin e fushës, znj. Luljeta Krasniqi. Gjatë këtij takimi, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen në detaje me të drejtat dhe detyrimet e tyre që rrjedhin nga shtylla e parë e AVS-it.

Pas prezantimit nga znj. Krasniqi, u zhvillua një debat i frytshëm, ku ekspertja u përgjigj me profesionalizëm pyetjeve të shumta nga të pranishmit.



## 8. EPER – shtylla e dytë LPP, 16 maj 2025

Më datë 16 maj 2025, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me EPER, u organizua një tjetër seancë informuese, kësaj radhe mbi pensionet profesionale (LPP). Sekretarja e Shoqatës, znj. Linda Rexhaj Maliqi, prezantoi në mënyrë të strukturuar aspektet kryesore të shtyllës së dytë të sigurimeve shoqërore, duke iu përgjigjur me përkushtim pyetjeve të shumta të pjesëmarrësve.

## 9. Kënga "Happy Birthday"

Ne muajin maj, gjatë qëndrimit të ekipit televiziv Heki-TV këtu në Gjenevë, grupi muzikor « Hareja » regjistroi videoklipin e ri « Happy birthday » për të cilin falenderojmë artistin Hekuran Krasniqi dhe Eliok Krasniqi – studio LMN.



## 10. Pritja e Presidentës së Republikës së Kosovës në Gjenevë, 22 maj 2025

Më 22 maj 2025, Shoqata Komuniteti Shqiptar, në bashkëpunim me shoqatën "Smira", organizuan një "Takim me mërgatën" për të mirëpritur Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, në sallën e Ecole de Vernier në Gjenevë. Gjatë këtij takimi u zhvillua edhe një program i shkurtër, por i pasur kulturor, që pasuroi atmosferën e ngjarjes.

Për organizimin e shkëlqyer të ngjarjes dhe në shenjë falënderimi, Presidentja i dhuroi Kryetarit Nasuf Nuhiut një stemë të Presidencës.



## 11. Pritja e mërgatës nga Presidentja Vjosa Osmani në Prishtinë, 31 korrik 2025

Më ftësë nga zyra e Presidencës së Republikës së Kosovës, me datën 31 korrik 2025, Kryetari i Shoqatës "Komuniteti Shqiptar i Gjenevës", z. Nasuf Nuhiu, mori pjesë në pritjen zyrtare të organizuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, në Prishtinë. Kjo ngjarje shërbeu si një moment i rëndësishëm për forcimin e lidhjeve ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe diasporës shqiptare.



Në pritje ishin të ftuar udhëhëqës shoqatash, profesionistë dhe veprimtarë të shquar të mërgatës nga fusha të ndryshme, duke reflektuar angazhimin e tyre të vazhdueshëm për çështjet kombëtare.

Me këtë rast, z. Nuhiu zhvilloi një takim të veçantë me zyrtarë të lartë të Presidencës së Republikës së Kosovës, ku u shkëmbyen ide dhe synime për thellimin e bashkëpunimit me mërgatën. Gjatë qëndrimit të tij në Prishtinë, ai pati gjithashtu mundësinë të vizitojë ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.



## 12. Festivali i 43-të në Kalabri, gusht 2025

Nga 07.08.2025-09.08.2025 grupi muzikor « Hareja » mori pjesë në festivalin e 43-të me radhë në San Demetrio Corone – Arbëreshe. Ashtu si ishte paraparë nga organizatori grupi “Hareja” u prezentua me shumë sukses në natën e parë të festivalit me 07.08.2025. Kurse

Të nesërmen të ftuar nga kryetari i komunës së San Giorgio Albaneze Mbuzati u prezentuan në një tjetër kocert.



E veçanta e këtij prezentimi ishte se vajzat e grupit “Hareja” ishin të veshura me kostume tradicionale Arbëreshe nga aktivistja e palodhur Mirela-njëherit rrobaqepëse e kostume tradicionale Arbëreshe.





Ky raport pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të Shoqatës "Komuniteti Shqiptar i Gjenevës" për ruajtjen dhe forcimin e identitetit tonë kombëtar, për kultivimin e gjuhës shqipe dhe trashëgimisë sonë kulturore por edhe rëndësinë që shoqata jonë ju jep aktiviteteve që i shërbejnë drejtpërdrejt jetës së përditshme të komunitetit shqiptar në Zvicër.

Falënderojmë me mirënjohje të thellë të gjithë kontribuuesit, bashkëpunëtorët dhe pjesëmarrësit, të cilët me përkushtimin e tyre bënë të mundur realizimin e këtyre aktiviteteve dhe forcimin e komunitetit tonë Shqiptar.

Në mënyrë të veçantë falënderojmë fotografimin Mentor Zajmin si dhe mediat: Alb'swiss TV, albinfo.ch, prointegra.ch, Sam24.info për përcjelljen dhe pasqyrimin e aktiviteteve tona.

Raportin e përgaditi: Linda Rexhaj Maliqi

Gjenevë, 31 gusht 2025

Sekretarja:

Kryetari:

---

Linda Rexhaj Maliqi

---

Nasuf Nuhiu